

## FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE DATA 22 QERSHOR 2023

E nderuar kryesuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në çdo demokraci të mirëqenë, në shtetin e së drejtës, Avokati i Popullit, si institucion, është diamanti i kurorës. Në vendin tonë, me përjashtim të punës së përkushtuar të këtij institucioni prej vitesh, aq më tepër në drejtimin aktual, nuk ka pasur atë mbështetje që të paktën ne si Kuvend duhej t'ia kishim garantuar në aspektin ligjor, të burimeve njerëzore, por edhe financiare. Përse ndodh kjo? Kjo ndodh për një fakt të thjeshtë, por edhe domethënës: Avokati i Popullit, që në destinacionin e vet kushtetues është një destinacion opozitar ndaj qeverisjes, por ne nuk kemi tolerancë për mendimin opozitar, qoftë institucional, qoftë politik, qoftë partiak. Ne jemi në një faze shumë të arrirë të njësimi të pushteteve. Ne kemi një parti, një qeveri, një Kuvend, një shtet dhe, mbi të gjitha, qëndron Ludoviku ynë, i cili na proklamoi përditë: "Shteti jam unë", por në një kohë që Ludoviku, ose Luigji XIV ishte krenaria e Francës së atëhershme, kreu i qeverisë është turpi i Shqipërisë së sotme.

Zonja dhe zotërinj të nderuar, Duke folur për të drejtat e njeriut, nuk mund të mos përmend sot se një qytetari, Dhionisius Alfred Beleri, i dhunohet në mënyrë arbitrare dhe nga çdo këndvështrim i jashtëligjshëm, liria; një kryetari të zgjedhur me mandat të ratifikuar në një prej 61 bashkive të vendit, i privohet e drejta kushtetuese për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë që i kanë ngarkuar bashkëqytetarët e tij. Një komuniteti, atij të Bashkisë së Himarës, i nëpërkëmbet e drejta klasike e sovranit. Pse të gjitha këto?! Thjesht dhe vetëm se nuk i pëlqen Ludovikut të parë të Shqipërisë. Mund të ketë dhe ka shumë aspekte të drejtësisë, të cilat e mbajnë në mënyrë të paligjshme të ndaluar zotin Beleri, por motivuesi dhe dirigjuesi i rrëmbimit dhe i pengmarrjes së zotit Beleri është Kryeministri i vendit. Pse e them këtë?! Shikoni kronikën e ngjarjeve më 6 maj, 1 javë e 2 ditë përpara zgjedhjeve të majit, ishte ai që dha sinjalin nga tubimi me banorët e supozuar të Himarës (të importuar ishin të gjithë ata) se nuk do të toleronte që himarjotët të shprehnin vullnetin e tyre, sepse duhej ta shikonin atë në sy dhe të vendosnin se kë do të zgjidhnin të parin e tyre. Ky motiv, i cili ishte denigrues, intimidues dhe nga çdo këndvështrim ishte abuziv dhe autarkik, vazhdoi për ditë të tëra kudo që u gjend, në Fier, në Lushnjë, në Kamzë, në Tiranë. Motivi ishte Fredi Beleri, stigmatizimi i tij, demonizimi i tij, me qëllim final rrëmbimin e Bashkisë së Himarës. Kjo vazhdoi deri në misionin e fundit, ku gjysmë ore përpara rrëmbimit të zotit Beleri, Kryeministri i vendit, Ludoviku I i Shqipërisë dha urdhrin: "Të rrëmbet, të mbahet peng, të drejtat të nëpërkëmben!". Të drejtat e komunitetit të Himarës, duke filluar nga ajo e zgjedhjes, e pronës, e identitetit shkelen dhe nëpërkëmben në mënyrë flagrante e të papranueshme dhe çuditërisht shoqërohen me një heshtje, një heshtje që do ta gjejmë të gjithë përpara në ecurinë e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të integritetit tonë evropian.